



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1003 Prot. 5

Tiranë, më 06/11/2015

REKOMANDIM

Nr. 36, datë 06/11/2015

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe neneve 80-104 të Ligjit nr. 8485, datë 12/05/1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të autoritetit "Dega e Doganës Tiranë".

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit nr. 186, datë 23/09/2015, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë subjektit "Dega e Doganës Tiranë", me objekt:

- Plotësimi nga ana e kontrolluesit të detyrimit për informim (neni 18) të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar dhe Udhëzimin Nr. 3, datë 05/03/2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme" i ndryshuar.
- Plotësimi nga ana e kontrolluesit të detyrimit për njoftim (nenet 21, 22) të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Subjekti "Dega e Doganës Tiranë", është institucion publik në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe ushtron aktivitetin e tij mbështetur në Ligjin nr. 8449 datë 27/01/1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", VKM nr. 205 datë 13/04/1999 "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor", ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë këtë fushë.

Gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, është konstatuar se ambientet në të cilat u shërbehet qytetarëve dhe ambientet e jashtme të godinës, janë të mbikëqyrura me sistem video-vëzhgimi (më poshtë sistem CCTV). Sistemi është i përbërë në tërësinë e vet nga kamera dhe pajisje video regjistruese.

Me provat e administruara gjatë këtij hetimi administrativ, konkludohet se sistemi CCTV i cili mbikëqyr ambientet e brendshme dhe të jashtme të godinës në të cilat ushtron veprimtarinë "Dega e Doganës Tiranë", është instaluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe administrohet nga Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit. Të gjitha veprimet e nevojshme

me qëllim riparimin, ndryshimin e këndit të vëzhgimit, kontrollin fizik të kamerave dhe administrimi i sistemit NVR, bëhet nga/me autorizimin e qendrës.

Bazuar në provat e administruara nëpërmjet fotografimit të ambienteve të mbikëqyrura nëpërmjet sistemit CCTV, konkludohet se kontrolluesi realizon informimin e subjekteve të të dhënave duke përdorur tabelat informuese, **të cilat nuk janë** sipas modelit standard të miratuar nga Komisioneri.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në cilësinë e kontrolluesit, e cila vetëm apo së bashku me të tjerë përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës, përgjigjet në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në Ligjin nr. 9887 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.

Nga verifikimi paraprak në Regjistrin Elektronik të njoftimeve të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, rezulton se kontrolluesi e ka plotësuar detyrimin për njoftim. Nga shqyrtimi i "Formularit të Njoftimit", konkludohet se nuk është vendosur personi i kontaktit çka mbetet një detyrim që duhet të realizohet nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Në zbatim të neneve 93-96 të Ligjit nr. 8485, datë 12/05/1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", është thirrur kontrolluesi "Drejtoria e Përgjithshme e Doganave" për tu paraqitur pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit, për tu dëgjuar në lidhje me pretendimet e mundshme.

Në përfundim të seancës dëgjimore, u konkludua se:

- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në cilësinë e "kontrolluesit", është **i vetmi përgjegjës** dhe **i vetmi kontrollues** për të gjitha Degët Rajonale Doganore në Republikën e Shqipërisë;
- Nuk është caktuar personi i kontaktit pranë kontrolluesit "Drejtoria e Përgjithshme e Doganave", çka duhet bërë në të ardhmen;
- Formulari i Njoftimit nuk është plotësuar në përputhje me nenin 22 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Sa më sipër,

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 31/pika 1/"a/1" të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative:

REKOMANDOJ:

1. Të zbatohet Udhëzimi nr. 3 datë 05/03/2010 "Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera" i ndryshuar, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
2. Të realizohet përditësimi i "Formularit të Njoftimit" pranë Zyrës së Komisionerit në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe të vendoset personi i kontaktit me zyrën e Komisionerit.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në cilësinë e "kontrolluesit", të marrë atributet si *i vetmi kontrollues përgjegjës*, në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, për të gjitha Degët Rajonale Doganore në Republikën e Shqipërisë.
4. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të kryhet plotësimi i këtyre detyrimeve brenda një afati 30 ditor, nga momenti i njoftimit të këtij Rekomandimi dhe pas këtij afati të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
5. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë, për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më 06/11/2015.

